

| | |
|--|-----------------|
| REPUBLIC OF KOSOVO MINISTRIE E FINANCËVE / MINISTARSTVO ZA FINANSIJE / MINISTRY OF FINANCE AGJENCIA QENDRORE E PROKURIMIT / CENTRALNA AGENCIA NABAVKA / CENTRAL PROCUREMENT AGENCY | |
| Nënie Org. Org. edinice Org. Unit | <u>A.Q.P.</u> |
| Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No. | <u>31/15</u> |
| Nr. i Tregime Broj Tregime No. Pages | <u>1/2</u> |
| Prishtine / Pristina | <u>05/03/15</u> |



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Financave –Ministarstvo za Finansije-Ministry of Finance
Agjencia Qendrore e Prokurimit/Centralna Agjencia Nabavka / Central Prokurment Agency

| | |
|------------------------|--|
| Datë/A: | 04.03.2015 |
| Për/Za/To: | Autoritetet Kontraktuese |
| CC: | Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP) |
| Nga/Od/From: | Mursel Racaj, Drejtor Ekzekutiv i Agjencisë Qendrore të Prokurimit |
| Tema/Subjekat/Subjekt: | Përgjigje për Autoritetet Kontraktuese për gjashtë (6) kategoritë e prokurimeve qendrore |

Të nderuar,

Në bazë të kërkesës së Agjencisë Qendrore të Prokurimit dhe në përputhje me nenin 95 të LPP, **Qeveria e Kosovës ka aprovuar listën e mallrave të përdorimit të përbashkët për gjashtë (6) kategori të prokurimeve qendrore.** Kjo listë është miratuar me **Udhëzimin Administrativ nr. 02/2015.** Artikujt e përdorimit të përbashkët, sipas **Shtojcës #1** të Udhëzimit Administrativ nr. 02/2015, janë:

1. Furnizim me karburante
2. Furnizim me material zyrtar
3. Furnizim me produkte higjienike
4. Furnizim me produkte të ushqimit
5. Furnizim me bileta
6. Furnizim me goma

Udhëzimi Administrativ mund të shkarkohet nga ueb-faqja e AQP-së: <http://aqp.rks-gov.net/sq/organizimi>.

Agjencia Qendrore e Prokurimit ka pranuar pyetje të shumta nga autoritetet kontraktuese lidhur me këto gjashtë (6) kategori të prokurimeve qendrore për të cilat janë të obliguara të zhvillojnë aktivitetet e prokurimit në bazë të planifikimeve përfundimtare të prokurimeve në institucionet e tyre përkatëse.

Si rrjedhojë, AQP njofton të gjitha AK-të:

1. Kjo listë e aprovuar është obligative për të gjitha **AK-të e nivelit qendror, Shtojca #2 e UA**, që do të thotë se AK-të e nivelit qendror **nuk mund të zhvillojnë aktivitetet e tyre të prokurimit** për kategoritë e përcaktuara në UA por këto aktivitete të prokurimit do të **udhëhiqen nga Agjencia Qendrore e Prokurimit.**

2. **Do të vazhdoj me zbatimin e këtij Udhëzimi Administrativ** duke respektuar afatet kohore të përcaktuara me LPP.
3. Në rast se kontratat e tyre aktuale do të skadojnë në një të ardhme të afërt, AK-të duhet të iniciojnë aktivitet e prokurimit për kategoritë e cekura më lartë për një kohëzgjatje **prej jo më shumë se një (1) vit** në mënyrë që kontrata e re e AK-së mos të përkoj me kontratën e prokurimit të përbashkët. Ky nen vlen për AK-të të cilat **janë të përfshira në Shtojcën #2 të UA.**
4. Sipas nenit 95.4 të LPP, një autoritet kontraktues mund të caktojë AQP-në për kryerjen e një aktiviteti të prokurimi në emër të tij. Andaj, të gjitha AK-të të cilat dëshirojnë të shfrytëzojnë kontratën e prokurimit të përbashkët të udhëhequr nga AQP, të parashtrojnë kërkesë në AQP duke specifikuar kategoritë e mallrave. Ky nen vlen për AK-të të cilat nuk janë të përfshira në Shtojcën #2 te UA.

Me respekt,